



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 194, Datë 30.08.2018

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “HIDROPOWER ELEKTRIK” SH.P.K, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 130, SERIA PV11K DHËNË SHOQËRISË “HIDROPOWER ELEKTRIK” SH.P.K, ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 59, DATË 22.06.2011, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET: “SLABINJE 2A” ME FUQI 2000 KW, “SLABINJE 2B” ME FUQI 1600 KW, “SLABINJE 2C” ME FUQI 1800 KW, “SLABINJE 2D”; “SLABINJE 2E” ME FUQI 3400 KW, ME FUQI TOTALE 13800 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 39, pika 4 dhe 43 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016 si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE - s, në mbledhjen e tij të datës 30.08.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me modifikimin e licencës nr. 130, Seria PV11K dhënë shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k, për hec-et: “Slabinje 2a” me fuqi 2000 kw, “Slabinje 2b” me fuqi 1600 kw, “Slabinje 2c” me fuqi 1800 kw, “Slabinje 2d”; “Slabinje 2e” me fuqi 3400 kw, me fuqi totale 13800 kw, me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 22.06.2011,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “SLABINJE 2A” me fuqi 2 MW, “SLABINJE 2B” me fuqi 1600 kW, “SLABINJE 2C” me fuqi 1800 kW, “SLABINJE 2D” me fuqi 5000 kW dhe “SLABINJE 2E” me fuqi 3400 kW, me fuqi totale 13800 kW për një periudhë 30 vjeçare, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 59, datë 22.06.2011.
- Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 393, datë 15.05.2018, ka kërkuar modifikimin e licencës nr. 130, Seria PV11K, për HEC – et e sipërcituar.
- Shoqëria Koncensionare “Hidropower Elektrik” sh.p.k, po ndërton HEC – et Slabinja 2, mbi lumin Shkumbin në zbatim të kontratës së koncensionit të formës BOT, nr. 2830 Rep dhe nr. 374 Kol, datë 03.09.2009, lidhur midis bashkimit të përkohshëm të shoqërive “LNK” sh.p.k dhe Euroterma Grup” sh.p.k. dhe METE, në cilësinë e Autoritetit Kontratues, të ndryshuar me kontratatë shtesë nr. 7169 Rep, dhe nr. 2194 Kol, datë 17.06.2013, ndryshuar me kontratat shtesë nr. 760 Rep dhe nr. 204 Kol, datë 05.10.2016, ndryshuar së fundmi me kontratë shtesë nr. 1206

Rep dhe nr. 512 Kol., datë 15.09.2017. Kjo kërkesë vjen si rrjedhojë e ndryshimeve të skemes së dalë gjatë zbatimit të punimeve që bëri të mundur rritjen e parametrave të fuqisë së instaluar.

- Disa nga shkaqet që cojnë në këtë modifikim:
  - Terreni i thyer, i papërshtatshëm dhe me formacione të paqëndrueshme, në territorin ku kalonte ndërtimi i veprave;
  - Punimet për veprat e derivacionit kalonin në tokat buqesore të zonës;
  - Në disa segmente gjurma kalonte në zona natyrore dhe arkeologjike të mbrojtura, për të cilat edhe pse të konstatuara me vonesë, subjekti i'u drejtua Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë i cili mbasi shqyrtoi raportin e vëzhgimit Sipërfaqësor në kuadër të zbatimit të projektit të HEC – eve “Slabinja 2B”, “Slabinja 2C”, “Slabinja 2D&2D/1” dhe “Slabinja 2E”, në zonën e Mokrës Pogradec, me vendimin nr. 239, datë 07.04.2017, miratoi lejen për këtë projekt.
- Në këtë situatë subjekti i'u drejtua MEI, dhe AKBN me kërkesën për ndryshimin e skemës së shfrytëzimit të HEC – eve “Slabinja 2”.
- MEI me shkresën nr. 73/50 Prot., datë 05.07.2017, i ka kërkuar AKBN të bëjë oponencën teknike për ndryshimet e projektit të zbatimit “Slabinja 2”.
- Referuar oponencës teknike të realizuar nga AKBN, rezulton se është eliminuar HEC – i “2A” nga skema, për shkak të kostove shumë të larta ekonomike dhe sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është relativisht e vogël, për rrjedhojë është reduktuar numuri i HEC – eve të parashikuara për t'u ndërtuar nga 5 në 4 impiante.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr.136, datë 25.06.2018, ka filluar procedurën për modifikimin e licencës nr. 130, Seria PV11K, dhënë për shoqërinë “Hidropower Elektrik” sh.p.k, me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 59, datë 22.06.2011, për prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et “SLABINJE 2A” me fuqi 2000 kW, “SLABINJE 2B” me fuqi 1600 kW, “SLABINJE 2C” me fuqi 1800 kW, “SLABINJE 2D” me fuqi 5000 kW dhe “SLABINJE 2E” me fuqi 3400 kW, me fuqi totale 13800 kW.
- Në vijim të sa më sipër, ERE ka bërë publikimin e vendimit të fillimit të procedurës në median e shkruar, me njoftimin nr. 55/43 Prot, datë 26.06.2018 dhe mbas përfundimit të afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, rezultoi se gazetari Geri Emiri me emailin e datës 30.07.2018, protokolluar në ERE në datën 31.07.2018, ka kërkuar Informacion mbi ndërtimin e HEC-eve Slabinja 2. ERE me shkresën nr. 532/1 Prot., datë 09.08.2018, i ka dërguar z. Emiri informacionin e kërkuar dhe ka dhënë spjegimet përkatëse për sa kërkuar në lidhje me Kontratën shtesë e Koncesionit nr. 1206 Rp dhe nr. 512 Kol, datë 15.09.2017; Hartën e vendodhjes së HEC-it si dhe vënien e tij në punë apo edhe vendimmarrjen finale të ERE mbi këtë modifikim.
- ERE me shkresën nr. 339/1 Prot, datë 05.07.2018 (Dërgim vendimi), ka njoftuar subjektin për vendimmarrjen e Bordit të ERE, mbi fillimin e procedurës, për modifikimin e licencës nr. 130, Seria PV11K, për HEC – et Slabinja 2 dhe me shkresën nr. 339/2 Prot, datë 05.07.2018, i ka kërkuar subjektit plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të korresponcencës së sipërcituar të ERE, “Hidropower Elektrik” sh.p.k me shkresën nr.186/1 Prot, datë 16.07.2018, ka përcjellë në ERE Formatin e Aplikimit si dhe tre Kontratat shtesë të Koncesionit respektivisht: nr. 7169 Rep dhe nr. 2194 Kol, datë 17.06.2013, ndryshuar me kontratat nr. 760 Rep dhe nr. 204 Kol, datë 05.10.2016, ndryshuar së fundmi me kontratën nr. 1206 Rep dhe nr. 512 Kol., datë 15.09.2017, siç kërkuar nga ERE.
- ERE në datën 20.08.2018, organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësues të “Hidropower Elektrik” sh.p.k, për të diskutuar në lidhje me Lejen e përdorimit të Ujit dhe atë Mjedisore dhe rifreskimit të tyre, sipas detyrës së lënë nga AKBN në Raportin e Oponencës Teknike, si dhe Miratimin nga OST pas ndryshimeve të fuqive të instaluara të HEC-eve.
- Në seancë përfaqësuesi i “Hidropower Elektrik” sh.p.k, deklaroi se lejet që ka depozituar në ERE nuk kanë nevojë për rifreskim pasi ndryshimet janë bërë vetëm në skemën e shfrytëzimit pa prekur fuqinë e instaluar totale të HEC-eve.
- Sa më sipër, sa konstatuar nga aplikimi fuqia totale e HEC-eve ka qënë 13800 kW dhe pas ndryshimeve të shfrytëzimit të HEC-eve është bërë 15085 kW.
- Nga analiza që i’u bë dokumentacionit të aplikimit si dhe dokumentave shtesë të depozituar në ERE nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k, në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Licencimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Licencave”, rezultoi i plotësuar pjesërisht si më poshtë:

- **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- gërma “a” (të dhënat për aplikim). Plotësuar;
- gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit). Plotësuar;
- gërma “c” (të dhëna për aplikuesin). Plotësuar;

Neni 15 pika 4:

- Gërma “a”, (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës); **Plotësuar**. Është argumentuar nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k se kërkesa për modifikim vjen për reduktimin e numrit të impianteve duke eliminuar HEC “Sllabinja 2A” me fuqi të instaluar 2MW, si dhe ndryshimet e fuqive të instaluara të HEC-eve të tjera “Sllabinja 2B”, “Sllabinja 2C”, “Sllabinja 2D&2D/1” dhe “Sllabinja 2E”.
- Gërma “b”, (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës); **Plotësuar**. Subjekti ka depozituar Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, të datës 20.04.2018, i cili miraton modifikimin e parametrave dhe kushteve të tjera të licencës për prodhimin e energjisë elektrike të HEC – Sllabinja 2D.
- Gërma “c”, (miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera); Plotësuar pjesërisht. Është depozituar në ERE nga subjekti shkresa e MEI nr. 73/54 Prot., datë 04.09.2017, “Për miratimin e projektit të zbatimit të ndryshuar, për ndërtimin e HEC – eve “Sllabinja 2B”, “Sllabinja 2C”, “Sllabinja 2D&2D/1” dhe “Sllabinja 2E”, si dhe kontrata shtesë e Koncesionit me nr. 1206, datë 12.09.2017, e lidhur midis MIE dhe “Hidropower Elektrik” sh.p.k në vijim të miratimit. Por

nuk janë depozituar të rifreskuara Leja Mjedisore, Leja e përdorimit të Ujrave si dhe Miratimi i OST pas ndryshimeve që kanë sjellë dokumentat sipërcituar.

- Gërma “d”, (ndikimet e pritshme të ndofikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licensuarit sipas legjislacionit në fuqi); **Plotësuar**. Reduktimi i numrit të hidrocentraleve nga 5 në 4, zvogëlon kufijtë koncesionarë duke garantuar respektimin e infrastrukturës, rritja e fuqisë së instaluar të prodhimit të energjisë elektrike nuk sjell asnjë impakt negativ, për detyrtimet e të licensuarit, sipas legjislacionit në fuqi. Në shkresën nr. 393/3 Prot., datë 17.07.2018, Subjekti “Hidropower Elektrik” sh.p.k ka sqaruar se prodhimi i energjisë mbetet i pandryshuar, 71 587 000 kW/h në vit, siç përcaktohet dhe në shkresën e MIE nr. 73/54, datë 04.09.2017, “*Miratimi i ndryshimit të projektit të zbatimit të hidrocentraleve në rrjedhën e lumti Shkumbin*” dhe në kontratën e koncesionit, datë 03.09.2009. Duke qënë se mbas marrjes së koncesionit janë bërë thellime të studimeve, projektuesit arritën në përfundimin që kaskada të ketë të njëjtat parametra teknikë si tek tenderi, ku nuk ndryshon prodhimi i energjisë në varësi të 1 numrit të HEC-eve, por sipas këndvështrimit të projektuesve dhe me miratimin e MIE të rritet fuqia në MW me kusht që të mos prekej asnjë nga kushtet e kontratës koncesionare, gjë që u pasqyrua edhe në kontratën shtesë të Koncesionit të formuluar mbas ndryshimit të projektit.
- Gërma “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE. **Plotësuar**.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

#### Vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k, për modifikimin e licencës nr. 130, Seria PV11K, për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga HEC-et “SLABINJE 2A” me fuqi 2 MW, “SLABINJE 2B” me fuqi 1600 kW, “SLABINJE 2C” me fuqi 1800 kW, “SLABINJE 2D” me fuqi 5000 kW dhe “SLABINJE 2E” me fuqi 3400 kW, me fuqi totale 13800 kW, të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE me vendimin nr. 59, datë, 22.06.2011, për një periudhë 30 vjeçare”, në perputhje me ndryshimet e reflektuara në kontratën shtesë të koncesionit nr. 1206 Rep dhe nr. 512 Kol., datë 15.09.2017, si më poshtë:
  - Referuar kontratës shtesë të koncesionit nr. 1206 Rep dhe nr. 512 Kol., datë 15.09.2017 bëhen ndryshimet si vijon:
    - Hec “Sllabinja 2B”, fuqi të instaluar 1800 kW;
    - Hec “Sllabinja 2C” me fuqi të instaluar 3400 kW;
    - Hec “Sllabinja 2D&2D/1”( fuqia e instaluar N/1. = 4885 kW dhe N/2. =1200 kW);
    - Hec “Sllabinja 2E” me fuqi te instaluar 3800 kW;
    - Dhe fuqi totale të instaluar N= 15085 kW,me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja dijani e këtij vendimi, të depozitohet në ERE lejen mjedisore, lejen e shfrytëzimit të ujrave, dhe miratimin e lidhjes me rrjetin e transmetimit, të lëshuara nga organet kompetente për fuqinë totale të instaluar 15085 kW.

2. Në rastin e mospërbushjes nga ana e subjektit “Hidropower Elektrik” sh.p.k të kushtit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ky vendim shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin dhe subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**